

Zyra e Këshillimit të Karrierës dhe Alumnit, në bashkëpunim me Njësinë Bazë të Metodologjisë së Mësimdhënies, zhvilluan aktivitetin me temë: "Pengesat e punës me fëmijët me nevoja të veçanta në aktivitetet në natyrë për moshën 0-6 vjeç". Aktiviteti u zhvillua në kuadër të Muajit të Ndërgjegjësimit të Personave me Aftësi Ndryshe.

Qëllimi i këtij aktiviteti ishte rritja e ndërgjegjësimit dhe njohurive mbi sfidat që hasin studentet e Arsimit Parashkollor dhe Edukatorët për zhvillimin e fëmijërisë së hershme 0-3 vjeç gjatë praktikave profesionale, në punën me fëmijët me nevoja të veçanta, veçanërisht në organizimin dhe zhvillimin e aktiviteteve në natyrë.

